

# 2014


**Polis University**

What is POLIS
Being student at POLIS
Graduation as a start
What does it means Being POLIS Almuni?

**Alumni**

Mision
Statute
Activities
Partners

**Members**

List
Interviews
Alumni at POLIS
Statistics


POLIS UNIVERSITY ALUMNI ASSOCIATION


UNIVERSITETI POLIS
TAW

## Misioni

POLIS është “Hapësirë Universitare për Mendim” në fushat e politikave për zhvillimin territorial-hapësinor, dizajnin e aplikuar, ndërtimtarinë dhe teknologjinë, si dhe për lidershipin qytetar e sipërmarrjen private.
Misioni i POLIS është sigurimi i “Njohurive, Teknologjisë dhe Lidershipit për zhvillimin dhe inovacionin.”
Nëpërmjet kërkimit shkencor dhe të aplikuar U_POLIS zhvillon e promovon “ekselencën shkencore dhe inovacionin”si dhe nëpërmjet edukimit akademik e praktik përmirëson kompetencën kreative dhe gjithëpërfshirëse.

## *Mission*

*POLIS is a "Space for Thinking" when it comes to topics like modern architecture , territorial-spatial development policies, applied design, construction and technology , civil enginnering but also civic leadership or private enterprenership ...*

*The mission of POLIS is to provide "Knowledge, Technology and Leadership for development and innovation." Through scientific and applied research, POLIS University develops and promotes "scientific excellence and innovation". Through academic and practical education, POLIS develops students’ creative and comprehensive competences*




U_POLIS
REKTORATI
FAED
FPMU
IKZH_POLIS
DEKANATI
Departamenti. 1
Arkitekture
Dizajn
Departamenti. 1
Planifikim
Mjedis
Departamenti. 1
Kerkim
shkencor
DEPARTAMENTE
Departamenti. 2
Shkenca
Departamenti. 2
Manaxhim
Departamenti. 2
Kerkim i
aplikuar
DEPARTAMENTE
INNOVATION FACTORY
Departamenti. 3
MAD Center
& Gallery
Departamenti. 3
Sust_Lab &
Innovation
Center
Departamenti. 3
Polis_PRESS
& Info Center
QENDRA
PARTNERE STRATEGJIKE
CO-PLAN
METRO_POLIS

POLIS UNIVERSITY ALUMNI ASSOCIATION

# POLIS University

2014 - 2015

## FAD

Faculty of Architecture Engineering & Art-Design

**PhD - Architecture & Design**
Double-Degree Program with Ferrara University Italy
(3 years, Full-time)

**Msc. in Architecture Restauration & Conservation of Heritage**
(2 years, 120 ECTS)
In preparation with UT

**MSc in Architecture & Urban Design**
300 ECTS
(5 years, Full-time)

**MSc in Applied Design**
120 ECTS
(2 years, Full-time)

**BSc in Art & Design**
180 ECTS
(3 years, Full-time)

**M.Prof in Aesthetic Structural Design**
90 ECTS
(2 years, Part-time)

**BSc in Civil Engineering**
180 ECTS
(3 years, Full-time)

**M.Prof in Parametric Architectural Design**
90 ECTS
(2 years, Part-time)

**M.Prof in Landscape & Urban Design**
90 ECTS
(2 years, Part-time)

Proffessional Master diploma are joint degree programs with IHS/Erasmus University Roterdam.

**Post Secondary Professional Diploma in Energy Efficiency**
120 ECTS
(2 years, Part-time)
Supported by EU/TEMPUS

**Certificate of Information Architecture & Creative Design:** 5 courses/weekends+ 18 ECTS post-BSc that can be transfered in the Master Studies

Implemented by SustLab POLIS University & MakeLab LawranceTech Detroit USA & Nitro-Saggio Group SicilyLab Italy

**SHENIM:**
*U_POLIS ka programe akademike full - time dhe part - time.*

*Programet part-time zhvillohen sipas nje shpemdarjeje, 1 ne 2 fundjava duke nisur nga mesdita e te premtes deri te dielen pasdite.*

---

## FPMMU

Faculty of Planning, Environment & Urban Management

**PhD - Urban Planning & Enviroment**
Double-Degree Program with Ferrara University Italy
(3 years, Full-time)
1700 Eur/Viti akademik

**MSc in Urban Planning and Urban Management**
300 ECTS
(5 years, Full-time)

**MSc in Urban Environmental Management**
(2 years/Full-time/120 ECTS)

**BSc in Enviromental Studies**
180 ECTS
(3 years, Full-time)

**M.Prof in Housing & Land Development**
90 ECTS
(2 years, Part-time)

**M.Prof in Urban Social Development & Human Resources**
(2 years, Part-time)

**M.Prof in Spatial Planning & GIS**
90 ECTS
(2 years, Part-time)

Proffessional Master diploma are joint degree programs with IHS/Erasmus University Roterdam.

**MBA Double-Degree with IPAG Paris, France**
90 ECTS
(2 years, Part-time)

3 specializations
- Innovation and Entrepreneurship
- Real Estate
- Marketing and Strategy

**MATRA/NUFFIC Certificates in "Urban Issues" from the Dutch Government:** 5 courses/weekends+ 18 ECTS post-BSc that can be transfered in the Master Studies

Implemented by Co-PLAN, POLIS University & IHS Roterdam, Erasmus University Holland.

↑← Mundesi transferimi kreditesh ECTS nga Certifikata ne M.Prof/MSc dhe sipas rastit ne PhD

**SHENIM:**
*- Programi PhD ne U_POLIS eshte diplome e perbashket me Universitetin e Ferrares ne Itali.*
*- Programet Master Profesional jane diploma te perbashketa me Universitetin Erasmus ne Rotterdam, Hollande.*
*- Programi MBA eshte diplome e perbashket me Universitetin IPAG ne France.*

## Studentët e POLIS/ *Students of POLIS*

Krahas formimit profesional në universitetin POLIS, studentët marrin edhe një lloj identiteti autentik – dicka që të gjithë polisianët e mbartin dhe që i bën ata të dallohen nga të tjerët. Të qënit student në POLIS do të thotë të kesh një “status” ndryshe dhe një lloj krenarie për atë që ti je dhe që po synon të bëhesh duke përcjellë tek të gjithë një imazh karakterizues mbi komunitetin e shkollës.

*In addition to professional education at POLIS University, students have already built an authentic identity encouraged by the unconventional and very special environment as well as the avant-garde teaching manners - something that distinguishes all POLIS students from others. Being a student at POLIS means carrying a different "status" which encompasses pride for what you are and who you aim to be in the future, always keeping in mind that each student positively represents the identity of POLIS community.*



## Hapësire pune / *Workspace*

POLIS është një laborator i madh në të cilin studentët punojnë mbi projekte të profileve të ndryshme, si dhe marrin një bazë të fortë teorike dhe praktike mbi degën përkatëse.

*POLIS is a huge laboratory in which students have space to engage in projects of different focus /profiles and where they obtain a strong theoretical and practical basis on the certain directions.*

## Kreativiteti / *Creativity*

Studentët stimulohen të zhvillojnë kreativitetin nëpërmjet ekspozitave dhe forumeve. Secili është i lirë të shfaqë dhe të zhvillojë krijimtarine e tij/saj në aktivitete ekstrakurrikulare, në gara lokale dhe ndërkombëtare.

*Students are motivated to develop their creativity through exhibitions and forums. Everyone is free to express and develop his/her creativity through extracurricular activities or participation at local and international competitions.*

## Jeta sociale / *Social life*

Ne POLIS studentët gjejnë një ambient social/kulturor ku takohen dhe shkëmbejnë ide dhe eksperienca si dhe organizime të aktiviteteve kulturore dhe artistike

*At POLIS University students participate in a social/ cultural environment where they meet and exchange ideas as well as are encouraged to partake in the organizations of other cultural and artistic activities.*







## Infrastruktura/
### *Infrastructure*

Stafi dhe studentët e POLIS kanë në shërbim të tyre një kampus modern të ndarë në dy ndërtesa si dhe njësite kërkimore dhe inovative në të cilat zhvillohen projekte të bazuar në praktika bashkëkohore. Partneriteti me universitete dhe institucione ndërkombëtare jep mundesinë e shkëmbimit të dijeve dhe krijimit të një rrjeti të gjërë.

*POLIS staff and students have a modern campus composed of two buildings. In the main building you can easily see a very special corner dedicated to Innovative Research Unit, within which students develop various thematical projects based on contemporary best practices. Partnerships with international institutions and universities provide the possibility of sharing knowledge and creating to a broader network.*



## Sipërmarrje /
### *Entrepreneurship*

Gjatë dy viteve të fundit të studimeve, studentët vihen në prove si sipërmarrës të rinj duke u ndarë në grupe dhe duke u angazhuar për të krijuar një sipërmarrje virtuale të mirëfillte e cila shkon deri në realizimin konkret te te gjtiha operacione-ve sipermarrese. Ky është një kapërcim i rëndesishëm në jetë dhe studentët stërviten për këtë që pa mbaruar studimet.

*During the last two years of their studies, students are tested as young entrepreneurs by being divided into groups and actively participating in creating a virtual enterprise which in a virtual way performs the tasks and duties of real enterprises with all operational stages. This is an important leap in life and POLIS students are well trained for their eventual immersion in the real world well before graduation.*



## Promovim talenti/
### *Talent promotion*

Krahas detyrave në fushën përkatëse studentët angazhohen edhe në klube studentore të komunitetit POLIS. Një nga sfidat e fundit që ato kanë ndërmarrë është dhe ideimi, shkrimi dhe kryerja e një shfaqe artistike teatrale ku studentët performojnë para një publiku duke mposhtur pasiguritë dhe duke vënë në dukje talentin e tyre. Në POLIS të gjithë studentët angazhohen në aktivitete me mision social. Misioni social eshte ne ADN e POLIS

*In addition to assignments in the relevant study area, students are also engaged in POLIS Student Clubs. One of the most current challenges they have undertaken is the design, the script and performance in a artistic drama show in which students perform before the public, thus overcoming their fears and uncertainties and showcasing their talent. At POLIS all students are engaged in activities with a social mission. Social dimension is in the very DNA of POLIS*





## Ceremonia e diplomimit / *Graduation Ceremony*

Kjo ceremoni zhvillohet në ambientet e universitetit me një aktivitet emocionues dhe jo tradicional. Nuk është thjesht një akt formal por një lancim në jetë dhe fillimi i një procesi ku studentët mund të venë në zbatim eksperiencën e fituar gjatë viteve të shkollës.

*The ceremony takes place in the university's premises and, in line with the school's modus operandi is entirely unique and unconventional. It is not just a formal act but a launch in life and the beginning of a process, during which students can put into practice the experience gained during the years of their studies.*

## Një fillim i ri/ *A new start*

Ky është një moment historik startimi për insititucionin dhe për brezat e diplomuar nga Universiteti POLIS. Shumë nga ata tashmë janë të punësuar dhe të angazhuar me Alumni. Ështëë kapërcim i rëndësishëm për profesionistët e rinj në përfundim të programeve 2, 3 apo 5 vjecare. Në këtë moment studentët marrin statusin "Alumni" dhe bëhen pjesë e komunitetit.

*This is a milestone for the institution and the generations that have graduated from POLIS University. Many of them are already employed and engaged in the Alumni (organization). It is an important leap for young professionals at the end of the 2nd, 3rd or 5th year programs. This point signals the moment in which students gain the "Alumni" status and become part of the community.*



## **Komuniteti i Alumni**/ *Alumni Comunity*

Studentët e diplomuar në POLIS kanë përgjegjësi të rëndësishme : përfaqesimin e denjë të vetes së tyre si profesionistë me një formim të plotë që ndryshon nga ai mesatar, por edhe përfaqësimin e një fryme dhe një institucioni që ka një imazh të vlerësuar në shoqëri dhe njihet për cilësinë e produktit të vet. Tradita e të qenit komunitet i POLIS vazhdon edhe pas përfundimit të studimeve duke dhënë një shembull të mirë e kontribut real në aspektin social e njerëzor , ku secili anëtar ka vecoritë e veta, ecurinë e tij dhe ku të gjithë bashkë plotësojnë njëri-tjetrin duke merituar të jenë pjesë e pandashme e POLIS.

*POLIS graduate students have important responsibilities: they need to be worthy representatives of themselves as professionals with a comprehensive training the spirit of reputable and well-known institution recognized for its high-quality product. The tradition of being a POLIS community member continues even after the completion of studies, in terms of showing a good example of a real contribution in social and human terms. At POLIS University each member has his/her own peculiarities, his/her own progress and everyone complements each other, thus earning their right to be an inseparable part of POLIS.*



Shoqata e ish-studentëve_ALUMNI, e përbërë nga Asambleja Kushtetuese dhe Bordi Ekzekutiv ushtron veprimtarinë e saj në koordinim të ngushtë me organet drejtuese të Universitetit POLIS dhe ka në fokus mbarëvajtjen profesionale të individëve që kanë kryer studimet në U_POLIS.

Nëpërmjet takimeve dhe aktiviteteve që organizon, shoqata ndihmon në transmetimin e ideve, nismave, inovacionit, bashkëpunimeve mes njëri- tjetrit, të cilat janë të nevojshme pas procesit të diplomimit dhe sidomos në përballjen me tregun e punës. Organet drejtuese të Shoqatës janë: Asambleja e Përgjithshme, Bordi Ekzekutiv dhe Kryetari.

## Të drejtat e anëtareve:

• Të jenë përfitues të mundshëm të ndonjë prej skemave apo programeve të asistencës të administruar nga shoqata Alumni.
• Te përfitojnë bursa studimi dhe të informohen për mundësi punësimi.
• Të ekspozojnë punët e tyre në njesitë dhe asetet e tjera të Universitetit POLIS.
• Të marrin pjesë në jetën sociale dhe aktivitetet e POLIS, Metro_POLIS, Co_PLAN dhe partnerëve të tyre.
• Të angazhohen në projekte të ndryshme dhe organizimin e TAW & TDW sipas nevojave dhe duke ju nënshtruar përzgjedhjes.
• Të njoftohen lidhur me aktivitetet e Shoqatës dhe gjithashtu të marrin pjesë në të gjitha funksionet shoqërore të Shoqatës.
• Të përfitojnë botime/revista të Universitetit POLIS me cmim të subvencionuar.

**Detyrimet:**

• Të gjithë anëtarët e shoqatës kanë detyrimin të paguajnë tarifën e anëtarësisë të përcaktuar në rregulloren e anëtarësisë,
• Të kontribuojne e mundësojnë mbarëvajtjen e shoqatës ALUMNI si dhe promovimin e talenteve të spikatura.

*The Association of Former ALUMNI students, consisting of the Constitutional Assembly and the Executive Board, exercises its activity in close coordination with the governing bodies of our University and is focused on the professional conduct of individuals who have graduated from POLIS.*

*Through organized meetings and activities, the association helps in the transmission of ideas, initiatives, innovation, in cooperation with each other, necessary after the graduation process especially when dealing with the labor market. The governing bodies of the Association are: the General Assembly, the Executive Board and the President.*

## Members' rights:

• *To be potential beneficiaries of any of the schemes or assistance programs administered by the Alumni association.*
• *To benefit scholarships and receive information about employment opportunities.*
• *To exhibit their works in units and other assets of POLIS University.*
• *To engage in the social life and activities organized by POLIS, Metro_POLIS, Co_PLAN and their partners.*
• *To engage in various projects and in the organization of TAW & TDW according to needs and through undergoing a selection.*
• *To be informed about the activities and also to take part in all social functions of the Association.*
• *Take advantage of the university's publications / magazines at subsidized prices.*

**Duties:**

*All association members have the obligation to:*
• *pay membership fees specified in the membership rulebook.*
• *contribute and enable a smooth running process of the Alumni Association as well as promote outstanding talents.*


LEGEA

## **Zgjedhjet** / *Elections*

Shoqata Alumni ka një përfaqësi e cila zgjidhet me anë të votimit nga pjesëtarët e saj. Kryetari ka një mandat vjeçar dhe ka të drejtë të rizgjidhet. Përgjegjësia e tij është të përfaqësojë shoqatën, të jetë aktiv dhe nxitës për organizime të ndryshme dhe të mbajë një databazë për shoqatën.

*Alumni Association representatives are elected through voting by Alumni members. The President has a mandate year and holds the right to be re-elected. His/her responsibility is to represent the association, be active and encouraging in terms of organizing various activities and maintain a database for the association.*








## **Takime periodike**/ *Periodic meetings*

Në periudha të pa caktuara anëtarët Alumni mblidhen për takime periodike të cilat ndodhin në vende të ndryshme të qytetit. Këto takime shërbejnë si një urë lidhëse për të ruajtur kontaktet me njëri-tjetrin dhe për tu ritakuar dhe shkëmbyer eksperienca të punëve të ndryshme që ata kanë kryer pas diplomimit në POLIS. Pjesë e aktiviteteve janë dhe ato sportive siç është Polis Football League.

*During certain undefined periods Alumni members are gathered for regular meetings which take place in different locations in the city. These meetings serve as a bridge of maintaining contacts with each other, seeing each other again in order to exchange experiences gained from various works after graduation. Part of Alumni activities are also sport activities such as the Polis Football League.*

## **Klube studentore** / *Student clubs*

Si gjatë viteve të shkollës edhe pas pëfundimit të saj studentët e POLIS duke bashkëpunuar midis tyre kanë arritur të krijojnë hapësira në qytet që janë kthyer në pika sociale takimi. Disa prej tyre janë: Googoats, ArchHouse, Destil etj. që frekuentohen jo vetëm nga Alumni por janë kthyer në sipërmarrje të konsoliduara.

*During school years but also after graduation, students collaborating between them have managed to create spaces in the city that have become social meeting places, such as: Googoats, ArchHouse, Destil etc. These spaces are attended not only by Alumni but have also become consolidated enterprises.*

## TAW/TDW & Architalks

Gjatë bienales së artit dhe arkitekturës Tirana Architecture Weeks & Tirana Design Weeks, pjestarët e shoqatës Alumni angazhohen në workshop-e të ndryshme në ndjekjen dhe organizimin e tyre duke patur lehtësira në pjesëmarrje. Architalks është një seri prezantimesh mbi punët e anëtarëve të shoqatës në kuadër të TAW.

*During the art and architecture Biennale "Tirana Architecture Weeks & Tirana Design Weeks" Alumni association members are engaged in various workshops in terms of following and organizing them and providing facilities for participation purposes. Architalks is a series of presentations of the work done by Alumni members in the framework of TAW.*




## Forume ne Polis / *Forums in Polis*

Universiteti POLIS ka një traditë të forumeve të hapura ku profesionistë të fushave të ndryshme prezantojnë përpara një audience. Emra të njohur të fushës së artit, dizajnit dhe shkencave të qytetit duke përfshirë këtu personalitete publike kanë qene motiv mbledhje për Alumni të cilët takohen në auditorët e POLIS për të parë prezantimet e forumeve.

*Open Forums have now become a tradition at POLIS University. Many professionals of different fields come to present their works in front of an audience. Well-known names in the field of art, design and science of the city including public personalities have been a motivation for alumni meetings. Usually they meet to attend various presentations that happen in the university auditoriums.*



## Këshilla mbi punesimin/ *Employment advice*

Në vitin e fundit të studimeve, studentëve të cilët janë pranë antarësimit në shoqatën Alumni u bëhet një prezantim ku jepen keshilla për punësim, modele CV, hartimi i sakte i tyre si dhe si të krijojnë një portofol të plotë dhe të kuruar të punëve që kanë bërë për të qene kështu të përgatitur për njoftime dhe oferta pune të ardhura në shoqatën Alumni.

*During the last year of their studies, students who are close to the Alumni Association membership are offered a presentation providing them with advice on employment, CV models, their precise formatting and how to create a full and cured portfolio of works done by them thus far in order to be prepared for any job announcements that come to the Alumni association.*







## **Aktivitete sociale** / *Periodic meetings*

Alumni POLIS jane nje komunitet aktiv ne projekte sociale, duke zhvilluar projekte ne bashkepunim me specialiste nderkombetare sic eshte rasti i workshop-it “Ne Lagje”qe trajton ceshtjen e rehabilitimit te zonave te lena pas dore ne qytet. Gjithashtu Alumni marrin pjese dhe ne konkurse te cilat shpallen gjate ketyre bienaleve te cilat prekin fushat e planifikimit, shkencave te qytetit dhe dizajnit.

*Polis Alumni are an active community in social projects, developing projects in collaboration with international experts such as the "In the Neighborhood" workshop which addresses the issue of rehabilitation of the city’s neglected areas. Alumni also participates in competitions which are announced during the biennale and which affect areas of planning, location and design sciences.*



## **“Selia” e Alumni**/ *Alumni residency*

Një nga pikat e takimit më frekuente për anëtarët e shoqatës është Destil, një ambient kreativ i krijuar dhe konceptuar nga vetë pjestarët e Alumni i cili ka si funksion primar bar/cafe por shërben edhe si një hapësirë sociale. Përveç këtyre, Destil është edhe një ambient studimi/prezantimesh/workshopesh ku janë zhvilluar takime të ndryshme, konferenca në fushën e arkitekturës & dizajnit si dhe ekspozita artistike.

*One of the most frequent meeting place for Alumni members is Destil, a nice environment created and conceived by several Alumni members. Destil functions as a bar/cafe but it also serves as a social space for social gathering. In addition, Destil is also used as a study environment, as a space for presenting different works/projects, a space for conducting various workshops, meetings, conferences in the field of architecture & design as well as art exhibitions.*

POLIS UNIVERSITY ALUMNI ASSOCIATION

# Partners and collaborators

UNIVERSITETI POLIS

KËSHILLI STUDENTOR POLIS

Co-PLAN

DESTIL

TAW TIRANA ARCHITECTURE WEEK

MetroPolis Associated, Architecture & Planning

GOOGOATS

TIRANA DESIGN WEEK

IF INNOVATION FACTORY

Mon Chéri coffee shop

nun

ANAA Albanian Netherlands Alumni Association

ALBANIA EXPERIENCE Destination Management Company

house ARCH Alternative space for Exhibition & Party

## Klaudia Cenomeri



**Dega:** Arkitekture

**Viti:** 2008 - 2013

**Position:** Arkitekte ne departamentin e administrimit te Bankes se Shqiperise

**Ku jeni e punësuar aktualisht (titulli) / viti:**
Nga marsi i vitit 2014 punoj pranë Bankës së Shqipërisë si specialiste arkitekte në Departamentin e Administrimit – sektori teknik.
**Përshkrim i vendit të punës dhe pozicionit aktual:** pozicioni im i punës konsiston në ndjekjen e çdo projekti arkitektonik dhe restaurimi të Bankës së Shqipërisë në Tiranë dhe në rrethe, ku BSH ka degët e saj operuese. Më specifikisht kam ndjekur punimet e projektit të ndertimit dhe rikonstruktimit të godinës qëndrore duke qënë ndër të tjera dhe pergjegjëse për pjesën e arredimit të brendshëm të godinës.
**Punë të mëparshme nëse ka / viti:** Para marrjes së kësaj detyre kam punuar si arkitekte e lirë për projekte të ndryshme arredimi si dhe projektimi të pjesëshme.
**Na trego historinë tënde mbi arritjet në karrierë:** Eshtë shumë shpejt për të folur për arritje në karrierë, pasi ajo sapo ka filluar, por kënaqesia që merret çdo ditë nga një punë e cila bëhet me pasion, është shumë e madhe. Të punosh pranë veprave që zënë vend në historinë arkitektonike të vendit është eksperiencë unike dhe patjetër një fillim i mbarë.
**Çfarë roli ka luajtur përvoja juaj në POLIS:** Në përfundim të studimeve pranë POLIS arrita në konkluzionin që POLIS ka qenë zgjedhja e duhur për mua. Netët e gjata pa gjumë, studimi me shumë këmbëngulje dhe bashkëpunimi me studentët e tjerë, kanë dhënë frytet e tyre duke më përgatitur në jetën profesionale që më priste pas përfundimit të studimeve. Pamvarësisht sfidave me të cilat përballet çdo student gjatë viteve të studimit pasioni dhe dashuria për këtë profesion të shtyn të ecësh përpara duke theksuar këtu që bashkëpunimi me stafin akademik të universitetit është thelbësor. Përkrahja e tyre profesionale, vizioni për arkitekturën dhe eksperienca personale të cilen na kanë transmetuar vazhdimish, ka ndihmuar shumë në formimin tim si arkitekte e re.

## Ana Hoxha



**Dega:** Architecture

**Viti:** 2007 - 2012

**Position:** Architect in Tirana Municipality

**Puna ime konsiston në:** kontrollin paraprak për përmbajtje të dokumentacionit tekniko-ligjor që shoqëron kërkesat për leje për kryerje punimesh, në përputhje me ligjin nr. 10119, dt. 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit" (i ndryshuar) / Mbledhjen dhe përpunimine informacionit rreth Planit të Përgjithshëm Vendor, Planet e Detajuara Vendore, lejeve të miratuara më parë dhe ato në proces shqyrtimi për zonën në të cilën bëhet kërkesa për leje dhe kryerje punimesh / formulimin e njoftimeve dhe raportit me propozimin për miratim me ose pa vërejtje/kushte, apo refuzimin e praktikës së kërkesave për leje për kryerje punimesh, në përputhje me afatet kohore të përcaktuara nga ligji nr. 10119, dt. 23.04.2009 "Për Planifikimin e Territorit" (i ndryshuar) / Konsulencë dhe asistencë të vazhdueshme për arkitektët apo për subjektet që aplikojnë për leje / kthim përgjigje të gjitha kërkesave dhe ankesave të subjekteve apo qytetarëve te interesuar rreth problemeve ose pretendimeve të ndryshme në lidhje me lejet e miratuara apo ato në proces shqyrtimi.
**Punë të mëparshme:** Prill 2013-Dhjetor 2014 – Sektori i Kontrollit te Zbatimit të Lejeve, në Drejtorinë e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Tiranë 2012 - Studio "Sfera"
Falë punës së vazhdueshme, në profesionin e arkitektes dhe falë experiencës që kam fituar kam kuptuar kompleksitetin e këtij profesioni. Megjithëse mendoj që ky është vetëm fillimi i karrierës time, arritjet e mia deri tani më kanë mundësuar për të qenë në pozitë ku unë mund të kontribuoj në procesin e projektimit arkitektonik dhe dokumentacionit ligjor.
Frymëzimi, eksplorimi, të menduarit pozitiv dhe sfida ndaj realitetit, janë disa nga principet kryesore të Universitetit POLIS. POLIS më ka pajisur me mjetet, teknikat dhe strategjitë për të krijuar lidershipin profesional, për të krijuar "hapësira të jetueshme", dhe më të lidhura me ambientin rrethues. Nëpërmjet kërkimit shkencor dhe të aplikuar si dhe edukimit akademik në Universitetin POLIS dhe falë punës sime të vazhdueshme, jam më e plotësuar nga ana profesionale, jo vetëm në pozicionin e punës ku ndodhem aktualisht por edhe në projekte private në fushën e dizainit dhe interierit. Kualifikimi në Universitetin POLIS më ka pajisur me njohuri të thelluara, të përditësuara dhe në përputhje me zhvillimet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

## Visar Haxhibeqiri



**Dega:** Arkitekture

**Viti:** 2009-2011

**Position:** Bashkë themelues i platformës "Cooperation Design –Atelie për Arkitekturë dhe DizajnUrban"

**Punë të mëparshme / viti:** Cultural Heritage Without Borders / Urba Plus/ ABC-engineering – My Home /"CMA - Construction Management Alliance Design" / Raiffeisen BANK Kosovo J.S.C., 10000 Prishtinë, Repulic of Kosova / "IKEJA INTERIUS"

**Na trego historinë tende mbi arritjet në karrierë:** Pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve (Bsc) në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në Prishtinë dega e Arkitekturës, (FNA), fillovatë punoj si teknik i arkitekturës në studiot e ish-profesorëve të mi, të cilëtndihmonin në digjitalizimin e projekteve. Ky fillim i ngritjes sime profesionale, pati ndikim të jashtëzakonshëmedhe në personalitetintim si arkitekt i ardhshëm. Më vonë ndoqa studimet Master i Shkencave në Arkitekturë dhe Dizajn Urban në Universitetin POLIS, në Tiranë – ku për dy vite të plota, lundrova dhe u brumosa me mundësitë e pafundme akademike që ofron universiteti në fjalë dhe mbrojta temën e diplomës me titull, "Roli i arkitekturës dhedizajnit urban në rivitalizimin dhe integrimin e identitetit dhe funksioneve të reja. Prishtina kryeqyteti i ri Evropian". Pas kësaj përvoje, fillova të punoj në Kosovë në fushën e restaurim, revitalizim, rikonstruksionit pranë CHWB – Cultural Heritage without Border, ku fokusi kryesor kaqenëtrajtimi i objekteve të trashëgimisë arkitekturore. Që nga viti 2012, vit nëtëcilin bashkë-themeluamplatformën Cooperation Design, stafi ynë, që sot ka 5anëtarë, ka qenë gjithmone i angazhuar në një sërë projektesh të natyrave të ndryshme Urbane dhe Arkitektonike. Universiteti POLIS mëka hapur horizontin duke u thelluar më shumë në pjesënteorike,artistike dhe filozofike, të cilat më pas mund tikonkretizoja në fushën arkitektonike. Kështu, eksperienca në POLIS pati ndikim të jashtëzakonshëmtek unë, dhe pa mëdyshje pati ndikim transformues, ku nga arkitekti (urbanisti/dizajneri urban) teknikishtkorrekt, por i ftohtëndaj leximit dhe interpretimit të konteksteve, më dha edhe natyrën filozofike të krijimittë hapësirave. Askundmë lehtë se në praktikat e POLIS-it, nuk ndodh qartësimi i pozicionimit të arkitektit karshi të kuptuarit tëproçesit të krijimit, duke filluar që nga frymëzimi, ideja ose koncepti e deri tek konkretizimi i saj nëvepër enë hapësirë. I gjithë ky transformim i bindjeve dhe praktikave të mia rreth gjithçkaje që ka të bëj me botën e arkitekturës,erdhi falë ekzistencës së POLIS-it, falë stafit tejet të përgatitur, të pedagogeve (vendas e ndërkombëtarë) dhe jetës sociale Brenda në POLIS.

**Pune te meparshme / viti:** Drejtor I Departamentit te Arkitektures ne Kompanin AlStone (Kosove)(2012-2015)

**Na trego historine tende mbi arritjet ne karriere:** Krahas bizneseve familjare dhe angazhimit prej 8 viteve ne sektorin e ndertimit, kam hapur edhe nje biznes privat bashk me 3 kolege tjere qe quhet Destil. Kjo sipermarrje ka nje funksion social dhe sherben si pike takimi per student dhe Alumni. dhe poashtu nje Studio te Arkitekture me nje grup Arkitektesh (FAS Architects).

**Cfare roli ka luajtur pervoja ne Polis:** Te jesh pjese e Universiteti Polis ka qene nder gjerat me te bukura edhe me te rendesishme qe me kan ndodhur. Keto pese vite te edukimit ne kete universitet ishin vitet me te rendesishme të formimit dhe pjekurise sime. Puna ne grup dhe lendet Studio me kane ndihmuar qe te jem gati te kryej profesionin tim. Polis eshte nje ambient ndryshe nga te tjeret dhe nga aspekti social dhe kulturor dhe kjo gje verehet tek mardhenia me studentet dhe me stafin

## Qendrim Gashi



**Dega:** Arkitekture

**Viti:** 2009-2014

**Position:** Menaxher në Destil Albania dhe Arkitekt në FAS Architects Studio

## Smeralda Lami



**Dega:** Arkitekture

**Viti:** 2008 - 2013

**Position:** Specialist për instrumente planifikimi, Urbanist/Arkitekt Pranë Bashkisë Berat

**Pozicioni im i punës konsiston në:** Hartimin e kërkesës për PPV-në dhe për IDV-të dhe PDV-të, të cilat hartohen ose ndërmerren nga Bashkia duke realizuar politikat e zhvillimit në përputhje me politikat shtetërore për të kryer investime të reja / përditësoj zonat për ndërtim mbi bazën e studimeve dhe instrumenteve të detajuara vendore / Bashkëpunoj si përfaqësuese e Bashkisë në hartimin e Planeve Ndërvendore dhe ato të Integruara, në të cilat merr pjesë edhe Bashkia e Beratit/ Nxis përgatitjen e instrumenteve të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit duke bashkërenduar me organe dhe struktura të specializuara brenda dhe jashtë vendit / bashkëpunoj për përcaktimin e zonave të pezullimit të zhvillimit, servitutit publik, rezervimit dhe preferimit ,nëse caktohen të tilla /bashkëpunoj në hartimin dhe rishikimin e rregullores vendore të kontrollit të zhvillimit dhe në hartimin e Raportit Vjetor për Zhvillimet në Territor.

**Punë të mëparshme:** Arkitekte në ndermarrjen "Eurobridge" / 2011 - 2015

Pozicioni në Bashkinë Berat më ka ndihmuar të rritem profesionalisht dhe të përballem me projektim dhe zbatim. Projektet konkrete në zona të ndryshme të qytetit, si dhe tipologjitë e ndryshme të projekteve të ndërmarra, më kanë përqasur me problematika dhe me zgjidhje konkrete të cilat në shkollë nuk mund të përftohen. Disa nga projektet tashmë po realizohen dhe shumë projekte të tjera presin miratim. Në një hapsirë kohore 1 vjeçare kam marrë pjesë në 14 projekte si dhe kam bashkëpunuar me studio të ndryshme projektimi.

POLIS ka qenë një përvojë shumë e mirë dhe konstruktive për mua. Ndryshe nga universitetet e tjerë të arkitektures POLIS më ka përkrahur në zhvillimin e kreativitetit dhe anës artistike të ndërthurur me praktikën, gjë e cila më bën të diferencohem në punën time. Kyuniversitet më ka përgatitur me të gjitha mjetet për të qenë e sukseshme si arkitekte, dhe më ka mësuar me metodologjine e punës që të kërkoj gjithmonë maksimumin ndaj vetes. Universiteti POLIS ka qenë një shkallë të cilën pasi e kapërceva më dha forcën e duhur për të vazhduar ngritjen nga ana profesionale.

## Fatjon Molla



**Dega:** Arkitekture

**Viti:** 2007-2012

**Position:** Arkitekt i objekteve të ndryshme

**Punë të mëparshme nëse ka / viti:** 1. Arkitekt & Dizajner (Stazh) NOVA Architect Gallery 10 / 2011 - 06 / 2012 2. Arkitekt & Dizajner NOVA Architect Gallery 06 / 2012 - 08 / 2013, 3. Master 2: Stratégies du Design / Master Jacques Viennot, ENSAAMA, Paris / www.ensaama.net 09 / 2013 - 09 /2014, 4. Arkitekt & Dizajner / Atelier Martel - Paris /www.ateliermartel.com /02 / 2014 - 10 / 2014

Historia ime si arkitekt ka filluar në vitin 2011, tek NOVA Architect Gallery ku për dy vjet kam punuar shumë projekte interesante dhe të rëndësishme njëkohësisht, kam mësuar shumë nga ana teknike e zhvillimit të projekteve po ashtu dhe në marrëdhenien me klientët.

Eksperienca ime në arkitekturë u zgjerua në Paris, ku për 8 muaj isha i punësuar tek Atelier Martel, një studio arkitekture në Paris.

**Gjatë këtyre muajve u mora me projektë të mëdha si:** - Spitalin e Zvicrrës në Paris, - 35 Banesa Kolektive, - Konkursin e 120 Banesave Kolektive në NYON, Zvicër, - Banesa të specializuara për persona Epileptikë, - Ristaurim dhe zgjerim i një qendre për riedukim profesional në Saint-Etienne, etj.

Eksperienca ime në POLIS ka qenë shumë e bukur dhe intesive, që nga dita e parë deri në momentin kur u diplomova, por këtë e kanë kuptuar të gjithë studentët e POLIS.

Une e kuptova akoma më shumë në momentin kur fillova masterin në Paris, ku u pershtata shumë mirë me menyrën e zhvillimit të masterit dhe me studentët e tjerë, kjo për të vetmen arsye sepse ishte e njejta frymë dhe filozofi si tek POLIS, aty kuptova që eksperienca në universitetin POLIS ka qenë shumë e rëndesishme për mua në zhvillimin tim si Arkitekt.

# Mariana Proko



**Dega:** Arkitekture

**Viti:** 2007-2012

**Position:** Arkitekte/

Dizajner në Studio Tred

**Përshkrim i vendit të punës dhe pozicionit aktual:** Është një sipërmarrje private në bashkëpunim me kolegen time Erialda. Nisma jonë për këtë studio është frymëzuar nga profesioni i Arkitekturës, i cili gjatë punës përveç vizatimeve teknike prodhon edhe modele 3 dimensionale, në mënyrë që të konkretizojë idenë e tij. Në këtë aspekt, shkenca na vjen në ndihmë me anë të pajisjeve 3D. Këto pajisje mundësojne prodhimin e modeleve 3dimensionale.

Roli i rëndësishëm arkitektit në shoqërinë tonë është i vështirë për tu pranuar dhe për këtë arsye nisma jonë rreth hapjes së studios ka hasur vështirësi në fillimet e saj. Ka nisur si fillim si një studio e specializuar në dizajn grafik por me potencial zhvillimi në një studio arkitekture në rritje që do ti shtojë vlera shoqërisë sonë për rëndësinë e rolit të arkitektit. Në këtë studio tashmë ofrohen të gjitha shërbimet grafike në fushën e 2d dhe një prodhim cilësor për të gjitha llojet e modeleve 3d, si dhe kryesorja, shërbimet në fushën e arkitekturës dhe dizajnit.
Përshkrim i eksperiencës suaj në POLIS, si ka ndikuar ajo në arritjet tuaja profesionale dhe çfarë përshtypjesh ju ka lënë përvoja juaj në universitet.

Studimet e mia 5vjeçare në POLIS më kanë mësuar të jemë një person që nuk heq dorë nga cfarëdolloj vështirësie që has në jetë dhe duke dhënë më të mirën nga vetja. Realitetit tonë i nevojiten persona me mendim të thellë njerëzor, mendim kyqë përdoret si bazë për të gjitha ndërhyrjet në ambjentin ku ne jetojmë. Në këtë aspekt POLIS di të udhëzojë më së miri.

Tregu Shqiptar për profesionin e Arkitektit është disi i vështirë për një student të sapo diplomuar, dhe nuk i ofron atij mundësinë për të provuar aftësite e tij për profesionin që ka zgjedhur. Kjo është një nga arsyet pse unë dhe kolegia ime Mariana ndërmorrëm një nismë private.
Të marrësh një nismë private pas mbarimit të 5viteve Arkitekturë nuk ishte aspak e lehtë. Hasnim çdo ditë fytyra tëçuditura të klientëve tanë pas marrjes së ketij vendimi por ja që në besuam në deshirën për të vazhduar një rrugë të re. Vazhdojmë akoma në këtë udhëtim edhe pse pas dy viteve të vështira do të thoja eksperiencë jo vetëm në arkitekturë por dhe në Design Grafik.
**Punë të mëparshme / viti:** Në Biznesin e familjes.
Pas dy viteve përvojë pune do të thoja se jam e kënaqur me hapin e parë që hodha në jetë për të njohur realitetin që fshihej diku jashtë, që prinderit më flisnin gjithmonë por që unë ende nuk e kisha provuar.Kam zbuluar se nuk kam frike të ndërmar nisma të tjera, sado të vështira apo të pamundura qofshin ato. Sapo kemi nisur të shkruajmë alfabetin e profesionit, dhe duhet akoma shumë punë për të arritur aspiratat që kemi. Vazhdimi i studimeve është një ndër planet e mia të ardhshme, por që akoma nvuk janë krijuar mundësitë për ti përforcuar ato.
Përshkrim i eksperiencës suaj në POLIS, si ka ndikuar ajo në arritjet tuaja profesionale dhe çfarë përshtypjesh ju ka lënë përvoja juaj në universitet. Asnjeherë nuk do bëhem pishman se pse une zgjodha POLIS për të mbaruar studimet e mia të larta.POLIS më mësoi se sa e vështirëështë të bëhesh dikush, se sa dëshirëdhe punë duhet për të nisur dhe përfunduar dicka. POLIS më ka dhënë gjithashtu mundësinë për të marrë pjesë në experienca/projekte. POLIS ka besuar tek dëshira ime për të qënë pjesë e eksperiencave të tyre.

# Erialda ZEKTHI



**Dega:** Arkitekture

**Viti:** 2007-2012

**Position:** Tred Studio

## Ledio Allkja



**Dega:** Menaxhim Mjedisor urban

**Viti:** 2012-2014

**Position:** Ministria e Zhvillimit Urban. Pozicioni përgjegjes i sektorit rajonal dhe vendor.

Pozicioni i cili mbuloj ka të bëjë me koordinimin e politikave kombëtare të planifikimit me qeverisjen rajonale dhe atë vendore. Ndër detyrat kryesore është dhe hartimi i dokumentave politike në planifikimin e territorit. Gjithashtu jam i përfshirë në hartimin e planit të përgjithshëm kombëtar dhe në hartimin e planit të integruar ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë Durrës.

**Na trego historinë tënde mbi arritjet në karrierë:** Pas mbarimit të studimeve në planifikim dhe zhvillim pronash në Angli, jam kthyer në shqipëri ku kam filluar punë si a/pedagog në universitetin POLIS. Si pjesë e skemës work &study nëPOLIS mu ofrua mundësia që përkrah punës të zhvilloj dhe një master në menaxhim mjedisor urban. Që nga Shkurt 2014 jam pjesë e MZHUT në pozicionin e përgjegjësit të sektorit.

**Cfarë roli ka luajtur përvoja nëPOLIS:** Gjatë periudhës në POLIS kam marrë një eksperience shumë pozitive. Ndërlidhja e elementëve teorik me praktiken e fortë qëPOLISka në planifikim ka qenë një ndër elementët më të rëndësishem në formimin e masterit. Njohuritë e marra në këtë master më kanë shërbyer për ngritjen e kapacitetit tim dhe zgjerimin e njohurive në fushën e planifikimit. Këto njohuri, më kane hapur shumë dritare të reja në profesion dhe tashmë janë kthyer në metodologji dhe parime bazë të cilat i ndjek në punën time të përditshme në planifikimin e territorit. Ambjenti miqësor dhe frymezues ka qenë një ndër gjërat që mëka bërë më shumë përshtypje dhe që më ka shtyrë më shumë përpara dhe motivuar për të mesuar e zhvilluar. Si një alumni, do të sygjeroja përvojën e POLIS për të gjithë ata të rinj apo dhe profesionistë të cilët duan të hapin dyer të reja në karrierë.

## Felissia Veliu



**Dega:** Arkitekture

**Viti:** 2008-2013

**Position:** Studio Arkitekture

**Ku jeni E punësuar aktualisht (titulli) / viti:**

Aktualisht punoj si arkitekte në një studio arkitekture, e përfshirë në të gjitha fazat e projekteve arkitektonike duke filluar nga projektimi paraprak, dizajni final deri tek vizatimet ekzekutive.Puna ime përfshin edhe përgatitjen e prezantimeve për klientët, takime me klientet dhe ekipin e projektimit, etj.

Kam rreth 4 vjet që punoj në profesion, duke filluar që në kohën kur isha studente, duke kombinuar shkollën me punën. Kam pasur gjithashtu edhe eksperienca si asistente e drejtorit të kantierit në një projekt relativisht të madh, duke parë nga afër cdo proces ndërtimi. Gjithashtu, për mua ka qënë shumë e vyer përvoja disa mujore si laburante pranë Universitetit POLIS, pasi mësova më shumë rreth marrëdhenieve mësimdhënës/student.

Mendoj se të flasësh për arritje është ende shpejt, jam akoma në hapat e para të karrierës sime dhe jam me fat që kam mundur të ushtroj profesionin ne një moshë kaq të re. Shpresoj që në të ardhmen të kem mundësi të jap një kontribut më të vyer për qytetin dhe shoqërinë.

POLIS nuk ka qënë vetëm një shkollë arkitekture, por më ka dhënë më shumë se sa vetëm dije rreth profesionit. Fryma e bashkëpunimit në grup, vlerësimi për të bukurën dhe estetiken, thellimi rreth një ideje ose një teorije, edukata për punën janë vetëm disa prej aspekteve që falënderoj POLIS-in. Përveç lëndëve në programin studimor, jemi njohur edhe me fusha të reja e inovatore, workshop-e me profesorë të huaj, eksperienca e udhëtime në vende fqinje ose edhe më tej. POLIS do të mbetet gjithnjë kontribuesi i parë dhe më i rëndësishëm në etjen time për t'u përmirësuar e mësuar gjithnjë e më shumë.

## Klaudja LLupo



**Dega:** Arkitekturë

**Viti:** 2007-2012

**Position:** Arkitekte

Aktualisht jam si freelancer architect, por kam bashkpunime me arkitektë të tjerë si dhe me studio arkitekture në lidhje me punë të ndryshme.
Kam qenë pjesë e Nova architect studio për 4 vjet. Eksperienca nga më të ndryshmet në interior dizajn si dhe eksterior. Pjesë e dizenjuësve të rrjetit të bar dhe coffee shop Mon Cheri. Dizenjuese e showroom si Ami event, Primavera Casa, Big Benpub, sushi bar Opium, restorant Millenium, dyqane Baby Drive,market Bio Mia, një sërë baresh e dyqanesh, apartamente, si dhe interierë tek kompleksi Rolling Hills, etj.
POLIS më ka ndihmuar të krijoj një koncept të qartë si funksionon një projekt arkitektonik si dhe ide të qarta rreth një dizenjimi funksional si dhe me shije. Më ka ndihmuar edhe në hapa vetëbesimi si unë mund të projektoj me cilësi.

## Greta Disha

**Dega:** Arkitekture

**Viti:** 2007-2012

**Position:** ManeTCI



Aktualisht jam duke punuar në kompaninë e ndërtimit ManeTCI, ku fillimisht jam marrë me projektimin e një objekti komercial dhe aktualisht ndjek procesin e zbatimit të projektit.
**Detyrat dhe përgjegjësitë e mia janë:** Përgatitja e vizatimeve në përputhje me kërkesat e klientit dhe me kriteret e projektit/ Shkëmbimi i informacionit me Projekt Menaxherin/ Raporti mbi ecurisë së punimeve;
Detyra të tjera që më ngarkohen /Kordinimi i punimeve civile me mekanike, elektrike/Kordinimi i punimeve të rifiniturave, pllaka, parket,dyer, hidrosanitare/Mbikqyr dhe raportoj për cilësine e punimeve të rifiniturës dhe cilësisë së materialeve/Zhvilloj takimet me klientët;
**Punë të mëparshme:** Part-time në A_11, një studio e specializuar në Interior Design. Prej Shtatorit 2012-Dhjetor 2012, kam punuar në Dea Studio. Janar 2013 - Prill 2013, kam patur bashkëpunim me Nova Architect Gallery, për dizajnin interior të disa objekteve me karakter komercial. Prej Prillit 2013-Janar 2014, kam punuar në kompaninë e dizajnit interior dhe mobilimit “Shaga”, ku kryesisht kam dizenjuar interierët e objekteve të banimit. Krahas punëve në studio dhe kompanitë e mësipërme, punoje dhe si freelance arkitekt. Hapat e para të karrierës sime kanë qënë bashkëpunime me studio dhe kompani, të ndryshme në fushën e dizajnin te brendshëm dhe dizajnit arkitektural. Pasmarrjes së disa eksperiencave, mjaft të rëndësishme përformimin tim si arkitekte, aktualisht punojnë një kompani ndërtimi. Në këtë kompani më është dhënë mundësia të jëmë pjesë e grupit projektues dhe zbatues, duke parë dhe prekur nga afër gjithë procesin që kërkon projektimi dhe zbatimi i një objekti arkitektonik. Përvoja në POLIS ka qënë mjaft interesante, për shkak të mënyrës se si është organizuari gjithë procesi i mësimdhënies. Orët e leksioneve të ndërthurura me klasat e studiove, si edhe workshop-et e ndryshme bënin që dita të ishte dinamike,dhe të jepte mundësinë të shpërfaqeshe në të gjitha dimensionet që janë shumë të rëndësishme për një arkitekt. Përvojë shumë e mirë kanë qënë projektet që duhej të punonim në grup, pasi jemi mësuar me frymën e bashkëpunimit me kolegët. Prezantimet që zhvillonim në çdo lëndë kanë qënë një ndihmë shumë e madhe për të zhvilluar aftësitë bindëse tek klientët.

# Aneta Spaseska



**Dega:** Arkitekturë

**Viti:** 2007-2013

**Position:** Arkitekte

**Where are you currently employed (title) / year:**
At a local architectural and engineering firm / 2013-ongoing
**Description of the workplace and the current position**
I work as an architect
**Earlier work if there are / year:**
POLIS University, Metropolis / 2011-2013
**Tell us your story about career achievements:**
After my master graduation, I only worked on two projects, both really interesting and with some sort of national importance. The first one is a pilot school, and currently i am involved in building a big surgical hospital.
**What has been the role of POLIS in this experience:**
Polis played a great role in building my capability to adapt and answer to a great variety of tasks and responsibilities.

# Arber Shala



**Dega:** Arkitekture

**Viti:** 2007-2012

**Position:** I vetëpunësuar

**Punë të mëparshme:** Arkitekt / Asistent i Projekt Menaxherit në Technische Hilfswerk, Rahovec, Kosovë; Arkitekt / Menaxher i Projekteve dhe Punishteve në SCHULER HELFEN LEBEN, Rahovec, Kosovë; Udheheqës i Zyrës, Koordinator Lokal, Udhehëqës i Arkitektëve në Arbeiter-Samariter-Bund, Prizren, Kosovë; Udhëheqës i Al-Trade Studio (Arkitekturë dhe Dizajn) nëAl-Trade Sh.p.k,Prishtinë, Kosovë.
**Arritjet në karrierë.**Fillova të studioj Arkitekturën më 1993 në Universitetin e Prishtinës, departamenti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, por nuk i përfundova studimet për shkak të luftës në Kosovë në vitet 1998-1999.Në vitin 2009, mora titullin Bachelor i Arkitekturës nga universiteti AAB në Prishtinë, duke kombinuar edhe studimet nga Univesiteti i Prishtinës.Në vitin 2012, mora titullin Master i Shkencave në Arkitekturë dhe Dizajn Urban nga Universiteti POLIS në Tiranë, Shqipëri. Menjëherë pas përfundimit të luftës së Kosovës në 1999, si një i pasionuar i Arkitekturës, fillova të punoj për OQ Gjermane, THW - "Technische Hilffswerk" si Arkitekt Junior, ku isha i përfshirë në rindërtimin e njësive të banimit dhe projekteve arsimore, sociale e kulturore në Kosovë. Në vitin 2001, fillova të punoj për një tjetër OJQ gjermane, ASB "Arbeiter Samariter Bund" si Udheheqës i Arkitektëve dhe koordinator lokal i projekteve. Në vitin 2007, jam graduar si Udhëheqës i Zyrës për ASB në Kosovë.Në vitin 2009, ijam bashkangjitur kompanisë vendore AL-TRADE si Udhëheqës i Studios për Arkitekturë dhe Dizajn dhe isha i përfshirë në projektimin dhe koordinimin e të gjitha projekteve të kompanisë por edhe të atyre që ndërlidheshin me kompaninë. Në vitin 2004, kam themeluar Arber SHALA Architects dhe jam autor dhe bashkë-autor i një game të madhe të projekteve të natyrave të ndryshme dhe në shkallë të ndryshme.Nga viti 2012, jam anëtarë / përfaqësues në Kosovë për Metropolis Associated, Architecture & Planning (studio në Tiranë, Shqipëri). www.metropolis.al POLIS nuk me ka zhgënjyer. Pritjet e miaishin të sakta, që nga vetë ambientet e shkollës, themeluesit e shkollës e deri tek stafi mësimdhënës. Përshtypje të mira gjithmonë më ka lënë qasja e stafit akademik karshi studentëve dhe sidomos filozofia e shkollës, e me këtë do të thoja se pikërisht kjo filozofi tek unë ka ndikuar që perceptimin dhe këndëvështrimin karshi arkitekturës ta ngre edhe në një nivel më të lartë.

## Joleza Koka



**Dega:** Arkitekturë

**Viti:** 2007-2012

**Position:** Studio Arch4 Kryetare e Forumit të Rinisë Eurosocialiste të Shqiperisë.

E punësuar aktualisht në Studio Arch4 dhe që nga Shkurt 2014dhe nëMinistria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, Drejtoria e Koordinimit të Politikave Rinore. Nga Korrik 2014 jam Kryetare e Forumit të Rinisë Eurosocialiste të Shqiperisë.

**Detyrat e mia janë:** Të koordinojë dhe zhvilloj politika rinore efektive dhe eficiente që nxisin zhvillimin social, kulturor dhe ekonomik të rinisë / Të propozojë dhe marrë pjesë në hartimin dhe përmirësimin e legjislacionit bazë në funksion të zhvillimit të politikave rinore / Të nxisë angazhimin për bashkëpunim të gjithë aktorëve që mbulojnë zhvillimin social, kulturor dhe ekonomik të rinisë dhe mbështesë nisma të cilat synojnë përfshirjen dhe pjesmarrjen e të rinjve shqiptarë si një element thelbësorë i vizionit strategjik /Të hartoj dhe propozoj aktivitete konkrete që synojnë përfshirjen e të rinjve në jetën publike dhe të koordinoj punën midis pushtetit ekzekutiv lokal dhe shoqërisë civile për përfshirjen e rinisë / Të propozoj, ndjekdhe monitoroj buxhetin e aktiviteteve në fushën e rinisë si dhe koordinoj projektet me donatorë. Studio Arch 4. Është një studio arkitekture qësë bashku me 3 koleg kemi krijuarpër të kthyer në realitet të ideve të shumë diskutuara gjatë viteve të studimit. Kemi patur fatin e madh që të eksperimentojmë me projekte nga më të larmishmet por jemi ende në hapat e parë. Në tre vitet e fundit, shumica e energjive të miaështëinvestuar në angazhimin për zhvillimin dhe avacimin e politikave rinore. Me shpresën që, në një të ardhme të afert do të këtë hapësira të zhvillimit të mendimit kritik ku do të mundësohej implementimi i projekteve më afatgjata që prekin interesat e të rinjve. Ka qënë e papërseritshme eksperienca e garës për kryetar të FRESSH. Gjatë 1 muaji kam vizituar çdo qytet të shqipërisë duke u përballur me realitete nga më të ndryshmet. Këto takime tani janë të vazhdueshme për shkak të detyrës si drejtuese e forumit. Profesioni i arkitektit është nga më të bukurit. Detyra e arkitektit është që të ketë një njohje të mirë të kontekstit, të analizojë potencialiet e vështirësitë, të krijoj një koncept të projektit dhe të gjej mënyrën se si do ia shpjegojëpartnerëve e palëve të interesuara zgjidhjen e propozuar, e në fund tëndjehet i realizuar kur krijimin e tij e fal në sherbim të njerëzve. Kjo mënyrë të menduari ta shndërron punën në grup si një veprim organik e jo detyrim. Përkushtimi për të transmetuar filozofinë e të punuarit grup nëpërmjet shëmbullit është një nga aspektet më pozitive të polisianëve.

Pjesë e stafit të Universitetit Polis janë edhe Alumni të cilët angazhohen në role të ndryshme

*Part of the staff of POLIS University are also Alumni engaged in different roles*



**Lorin Cekrezi**
**Innovation Factory**



**Rezart Struga**
**Metropolis**



**Fiona Imami**
**Co-Plan**



**Gjergji Dushniku**
**Njësia e cilësise**



**Renis Batalli**
**Innovation Factory**



**Saimir Kristo**
**Assistant Dean**



**Eranda Janku**
**Innovation Factory**



**Malvina Istrefaj**
**Marketing**



**Figali Dardha**
**Metropolis**



**Dea Buza**
**Innovation Factory**



**Joana Dhiamandi**
**Polis Press**



**Silvi Jano**
**Co-Plan**



**Kejt Dhrami**
**Co-Plan**



**Gerdi Papa**
**Metropolis**



**Nevila Zaimi**
**Metropolis**



**Ermal Hoxha**
**Polis Press**



**Julia Janku**
**Administration**



**Marseda Allajbeu**
**Administration**



**Gerti Delli**
**Co-Plan**


UNIVERSITETI POLIS

Alumni Arkitekture & Dizajn 1

**Viti akademik: 2011**

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 1 | Aida | Kulaj |
| 2 | Andiol | Aliaj |
| 3 | Aneld | Kendezi |
| 4 | Arber | Kokoshi |
| 5 | Belina | Kodra |
| 6 | Flamur | Grajçevci |
| 7 | Glodian | Dauti |
| 8 | Halit | Sadiku |
| 9 | Joana | Dhiamanti |
| 10 | Kreshnik | Turabi |
| 11 | Linda | Loka |
| 12 | Lisana | Piro |
| 13 | Migena | Mertiri |
| 14 | Miranda | Rashani |
| 15 | Naim | Hajdari |
| 16 | Persida | Shkrepa |
| 17 | Rais | Petrela |
| 19 | Saimir | Kristo |
| 18 | Silva | Kushi |
| 20 | Visar | Haxhibeqiri |

Alumni Arkitekture & Dizajn 1

**Viti akademik: 2012**

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 1 | Aurora | Gjika |
| 2 | Dorjana | Malaj |
| 3 | Edison | Ribaj |
| 4 | Eglantina | Haxhiu |
| 5 | Elona | Saro |
| 6 | Endri | Bega |
| 7 | Eno | Muho |
| 8 | Enola | Isufi |
| 9 | Erinsa | Shehu |
| 10 | Erti | Mene |
| 11 | Hektor | Jorgo |
| 12 | Iris | Gjashta |
| 13 | Malvina | Istrefaj |
| 14 | Malvina | Kallabaku |
| 15 | Nevin | Bilali |
| 16 | Ujeza | Gjedia |

Alumni Arkitekture & Dizajn 2

**Viti akademik: 2012**

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 1 | Adri | Hafizi |
| 2 | Agi | Çeka |
| 3 | Akid | Fani |
| 4 | Amarildo | Fejzulla |
| 5 | Ana | Hoxha |
| 6 | Andi | Qerosi |
| 7 | Anisa | Spahiu |
| 8 | Arber | Shala |
| 9 | Ardit | Muka |
| 10 | Benjamin | Kabashi |
| 11 | Brixhilda | Biçaku |
| 12 | Denis | Djaloshi |
| 13 | Elsid | Kabetaj |
| 14 | Elton | Nino |
| 15 | Emil | Spiro |
| 16 | Endri | Kanani |
| 17 | Enea | Lici |
| 18 | Erialda | Zekthi |
| 19 | Erlend | Baballeku |
| 20 | Ervis | Taka |
| 21 | Fatjon | Molla |
| 22 | Fiona | Hoxha |
| 23 | Florid | Virjoni |
| 24 | Gabriel | Kokalari |
| 25 | Gjergj | Dushniku |
| 26 | Greta | Disha |

Alumni Arkitekture & Dizajn 2

**Viti akademik: 2012**

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 27 | Igli | Sala |
| 28 | Ilirjan | Palushi |
| 29 | Ina | Musai |
| 30 | Ira | Aga |
| 31 | Iva | Baze |
| 32 | Joleza | Koka |
| 33 | Jonida | Veizi |
| 34 | Klaudia | Llupo |
| 35 | Klaudio | Cari |
| 36 | Klesta | Koçi |
| 37 | Klodian | Troci |
| 38 | Lisiena | Dimo |
| 39 | Lorela | Malshi |
| 40 | Lorenc | Drita |
| 41 | Lorin | Çekrezi |
| 42 | Mariana | Proko |
| 43 | Marina | Mekshi |
| 44 | Nevila | Zaimi |
| 45 | Olesja | Lami |
| 46 | Rezart | Struga |
| 47 | Saljon | Çizmja |
| 48 | Serdi | Fejzullai |
| 49 | Shpend | Barçi |
| 50 | Silvi | Dodaj |
| 51 | Sindi | Toka |
| 52 | Tomorr | Menzelxhiu |
| 53 | Xheladin | Hoxha |

Alumni Arkitekture & Dizajn 3

**Viti akademik: 2013**

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 1 | ADNAN | BISLIMI |
| 2 | ANA | SHURDHA |
| 3 | ANDI | SINANAJ |
| 4 | ARLINDA | DULAJ |
| 5 | ARNISA | JAHAJ |
| 6 | ARSIDA | AJAZI |
| 7 | ATNAN | KRYEZIU |
| 8 | AXHION | TAGANI |
| 9 | BESART | GJANA |
| 10 | BRIKEN | MILOTI |
| 11 | DONISELA | MAMANI |
| 12 | EDUINA | JAUPI |
| 13 | EGES | MADHI |
| 14 | EJOLA | DOCI |
| 15 | ELENI | LICI |
| 16 | ELIOS | KOVACI |
| 17 | ENDRIT | ZENELI |
| 18 | ETRIZENA | FERRAJ |
| 19 | FELISSIA | VELIU |
| 20 | FLORIAN | HYSI |

Alumni Arkitekture & Dizajn 3

**Viti akademik: 2013**

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 21 | IRA | SHALZI |
| 22 | IRISA | ZUSI |
| 23 | JONIDA | KANANAJ |
| 24 | JUXHIN | BALLIU |
| 25 | KETI | HOXHA |
| 26 | KLAUDIA | CENOMERI |
| 27 | KLODIAN | BALA |
| 28 | LORENA | XHAXHO |
| 29 | LORENA | BAJOLLARI |
| 30 | MAMICA | BURDA |
| 31 | NEADA | BULLAJ |
| 32 | OLISA | FOTO |
| 33 | OLTI | SHABANI |
| 34 | RENIS | BATALLI |
| 35 | SAMAELA | LALA |
| 36 | SANJOLA | MAHMUTAJ |
| 37 | SMERALDA | LAMI |
| 38 | STIVI | BALLI |

Alumni Arkitekture & Dizajn 4

**Viti akademik: 2014**

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 1 | ALDO | MIHO |
| 2 | ALEKSANDER | JUSHI |
| 3 | AMANDA | MECO |
| 4 | ANDI | KOHILA |
| 5 | ANDUENA | DRAGOVI |
| 6 | ARISTEA | DINAKU |
| 7 | ARMAND | PRELEZI |
| 8 | BLERTI | BAJO |
| 9 | DEA | BUZA |
| 10 | DEAN | HADO |
| 11 | DESIAN | DYRMISHI |
| 12 | EGLA | HARXHI |
| 13 | EGZON | PLLANA |
| 14 | ELJANA | ZENAJ |
| 15 | EMEL | PETERCI |
| 16 | ENIA | SALILLARI |
| 17 | ERIKETA | RENJOLLARI |
| 18 | ERMAL | HOXHA |
| 19 | FIGALI | DARDHAJ |

Alumni Arkitekture & Dizajn 4

**Viti akademik: 2014**

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 20 | GENC | TUFI |
| 21 | GERDI | PAPA |
| 22 | GIDIAN | HAJDERAJ |
| 23 | GJINOVEFA | XINXO |
| 24 | GLEIDIS | MISJA |
| 25 | IRMA | NAZARI |
| 26 | JOLI | KIKA |
| 27 | JONA | QIRICI |
| 28 | JURGEN | TURKESHI |
| 29 | KLAJDI | DINELLARI |
| 30 | KLEVIS | BREGU |
| 31 | MANUELA | GJOKA |
| 32 | NADINA | SULA |
| 33 | ONA | ZENELAJ |
| 34 | QENDRIM | GASHI |
| 35 | RENISA | MUKA |
| 36 | ROMIR | MAZARI |
| 37 | SHEJLA | HASANI |
| 38 | SONILA | BRAHOLLARI |

Alumni MSC NE PLANIFIKIM DHE MENAXHIM URBAN 1

**Viti akademik: 2012**

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 1 | Dashnor | Poçi |
| 2 | Ermir | Nasi |
| 3 | Elvis | Gjika |
| 4 | Ela | Goxhaj |
| 5 | Fatjon | Devollaj |
| 6 | Gezim | Bela |
| 7 | Iris | Kashariqi |
| 8 | Kedis | Burrja |
| 9 | Mirzeta | Kashnica |
| 10 | Mario | Shllaku |
| 11 | Refation | Dobi |
| 12 | Renaldo | Gaçe |
| 13 | Silvi | Jano |

Alumni MSC NE PLANIFIKIM DHE MENAXHIM URBAN 2

**Viti akademik: 2013**

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 1 | GERTI | DELLI |
| 2 | ARION | SAUKU |
| 3 | GENC | MINAROLLI |
| 4 | ENDRIT | GALLO |
| 5 | ERMAL | KOLA |
| 6 | MARSEDA | ALLAIBEU |
| 7 | ERSILA | COLLAKU |
| 8 | ALBI | HASA |
| 9 | NERMIN | BARJAMI |
| 10 | ERVIS | LILA |
| 11 | FIORENTINA | DOLLANI |

Alumni MSC NE PLANIFIKIM DHE MENAXHIM URBAN 3

**Viti akademik: 2014**

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 1 | ERANDA | JANKU |
| 2 | IMELDI | SOKOLI |
| 3 | FABJOLA | MECAJ |
| 4 | SHPENDI | BALILAJ |
| 5 | BLEDI | ISARAJ |
| 6 | JULIAN | KAPLLANI |
| 7 | ENEIDA | CELA |
| 8 | MALVINA | DISHA |
| 9 | RUDIEN | CALI |
| 10 | KEJT | DHRAMI |
| 11 | IDIT | RIZA |
| 12 | FJONA | IMAMI |
| 13 | EGI | BOZO |

Alumni Bachelor Art dhe Dizajn 1

**Viti akademik: 2013**

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 1 | KLAUDIA | SORRA |
| 2 | ANA | HOXHA |
| 3 | DURIM | HOTI |
| 4 | XHOI | MUSLIAKA |
| 5 | XHESIKA | BERISHA |
| 6 | KRESHNIK | ILIAZI |
| 7 | SERENA | LEKA |

Alumni Bachelor Art dhe Dizajn 2

**Viti akademik: 2014**

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 1 | JULIA | JANKU |
| 2 | KOZMA | MATA |
| 3 | IRIDA | GURI |
| 4 | KIBELA | NASUFI |
| 5 | MARIA | TASHO |
| 6 | ILVA | QEJVANAJ |
| 7 | KRISTI | NIKOLLA |
| 8 | MONIKA | PORECI |
| 9 | KIARA | HYSA |
| 10 | HEKURAN | DYLAZEKA |
| 11 | ENO | GOXHA |

MSC MENAXHIM MJEDISOR URBAN 1

**Viti akademik: 2014**

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 1 | MARENGLEN | GJOKA |
| 2 | SAIMIR | LAMCE |
| 3 | BILAL | KOCI |
| 4 | LEONORA | PACILI |
| 5 | DONALD | DEDA |
| 6 | VILMA | KADESHA |
| 7 | SUELA | NEZIRAJ |
| 8 | BLERINA | DUSHNIKU |
| 9 | ROBERT | NAZARI |
| 10 | XHEVDET | FERRO |
| 11 | MATILDA | SULAJ |
| 12 | LEDIO | ALLKIA |
| 13 | ELVA | SHALA |

BSC STUDIME MJEDISORE

**Viti akademik: 2014**

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 1 | ART | BEJTULLAHU |
| 2 | SILVA | DAKU |
| 3 | ISIDA | RRAPI |
| 4 | EUGEN | DEDAJ |

MSC NE DIZAIN TE APLIKUAR 1

**Viti akademik: 2013**

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 1 | LISANA | PIRO |
| 2 | SONIA | JOJIC |
| 3 | JOANA | DHIAMANDI |
| 4 | SAIMIR | KRISTO |

MSC NE DIZAIN TE APLIKUAR 2

**Viti akademik: 2014**

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 5 | REZART | STRUGA |

## MASTER PROFESIONAL

POSTMASTER Dizajni urban dhe pejsazh

Viti akademik: 2013

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 1 | Agron | Mesi |
| 2 | Dorina | Papa |
| 3 | Endrit | Marku |
| 4 | Etleva | Dobjani |
| 5 | Juljan | Veleshnja |
| 6 | Ledian | Bregasi |
| 7 | Nedi | Petri |
| 8 | Stefano | Romano |

## MASTER PROFESIONAL

POSTMASTER Strehim dhe zhvillim toke

Viti akademik: 2013

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 1 | Afërdita | Caco |
| 2 | Redion | Biba |
| 3 | Gentian | Selmani |
| 4 | Anila | Gjika |
| 5 | Darina | Kokona |
| 6 | Merita | Guri |
| 7 | Teida | Shehi |
| 8 | Elona | Karafili |
| 9 | Altin | Mihali |
| 10 | Rudina | Toto |

## MASTER

Aesthetik

Viti akademik: 2013

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 1 | BURIM | SADIKU |
| 2 | OLGICA | NELKOVSKA |
| 3 | ARTA | SELIMI |
| 4 | ANETA | SPASESKA |

## MASTER

Landscape

Viti akademik: 2013

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 5 | ARDIT | LILA |
| 6 | ERDI | MYFTARAGA |
| 7 | GENCI | SHTETO |

## MASTER

Parametrik

Viti akademik: 2013

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 8 | ILDA | QAZIMLLARI |
| 9 | ARSIM | GERXHALIU |
| 10 | SKENDER | PALLOSHI |
| 11 | FAHRUSH | AZEMI |
| 12 | ANISA | MANE |

## MASTER

Gis

Viti akademik: 2013

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 13 | ORION | HASANAJ |
| 14 | PREN | DOMGJONI |
| 15 | BORIANA | GOLGOTA |
| 16 | RUDINA | (JONUZI) VASILI |
| 17 | ENEJDA | SERAJ |
| 18 | KLEA | PAPANDO |
| 19 | JOHANA | KLEMO |
| 20 | EDLIRA | MEMA |

## MASTER

Housing

Viti akademik: 2013

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 21 | MIREDA | THANA |
| 22 | FJOLLA | PERJUCI |
| 23 | BESMIRA | DYCA |
| 24 | ELIZABETA | POLJOSKA |

## MASTER

Human Resources

Viti akademik: 2013

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 25 | ISELA | JANKA |

## MASTER

Human Resources

Viti akademik: 2014

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 26 | ERLI | ZDRAVA |
| 27 | ARBER | HOTI |

## MASTER

Parametrik

Viti akademik: 2014

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 28 | NYSTRET | KOCA |
| 29 | ALBANA | MORINA |

## MASTER

Aesthetic

Viti akademik: 2014

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 30 | IRMA | TEMALI |

## MASTER

Landscape

Viti akademik: 2014

| Nr. | Emer | Mbiemer |
|---|---|---|
| 31 | ARDI | DHIMA |
| 32 | DORIANA | MUSAJ |
| 33 | DONIKA | CETTA JUNCAJ |




| Total Te Punesuar | 266 | 100% |
|---|---|---|
| Te punesuar ne sektor Publik | 59 | 26% |
| Te punesuar ne sektor Privat | 123 | 49% |
| Te Vetepunesuar | 57 | 16% |
| Kryejne stuidme /kualifikme | 27 | 9% |




| Total Alumni | 298 | 100% |
|---|---|---|
| Te Punesuar | 266 | 90% |
| Ne kerkim per ripunesim | 32 | 10% |




| Publik | Privat | Vetepunesim | Ne kerkim per ripunesim | Studime / Kualifikime te metejshme | totali |
|---|---|---|---|---|---|
| 59 | 123 | 57 | 32 | 27 | 298 |
| 21% | 41% | 19% | 10% | 9% | 100% |

# Shoqata Alumni e Universitetit POLIS

ADRESA: Rr. Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar
Kodi Postar 1051, Kutia Postare 2995, Tirana, Albania.

WEB: www.universitetipolis.edu.al

EMAIL: alumni_contact@universitetipolis.edu.al

TEL: + 355.(0) 4 240 74 20 / 240 74 21

FAX: + 355.(0)4 240 74 22

ADRESA: Rr. Qemal Guranjaku, Tirana 1001, Albania

WEB: www.destil.al

EMAIL: info@destil.al

TEL: +355 (0) 69 885 2388